



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA EKONOMIKE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
SEKTORI TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

NJOFTIM

Per Taksapaguesit e Bashkise Vau Dejes:

1. Njoftojme subjektet taksapaguese, qe kane detyrime te prapambetura sipas kategorise Individ/Biznes, se ne mbeshtetje te ligjit nr. 86/2025 “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”, Udhëzim i Ministrit të Financave, Nr. 6 datë 6 .03. 2026 “Për zbatimin e ligjit nr. 86/2025, “për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”,

- Falen plotesisht detyrimet vendore deri me **30.12.2014**
- *Per vitet 2015-2019, subjektet qe kane detyrime, ju falen/shuhet 50% e detyrimit, nese pjesen tjeter prej 50% e paguajne deri me 30 qershor 2026, dhe ju falen/ shuhen 25%, nese pjesen tjeter prej 75% e paguajne deri me 31.12.2026. Gjobat e kesaj periudhe falen nese paguhet detyrimi kryesor (principal)*
- *Per vitet 2020-2024, falen gjobat dhe kamat vonesat nese paguhet detyrimi kryesor (principali) deri me 31.12.2026*
- *Nuk perfitojne nga ky ligj , subjektet qe jane denuar me vendim gjyqesor te formes se prere, ose qe jane ne proces gjyqesor apo hetimi penal per vepra ne fushen tatimore dhe /ose doganore*

2. Njoftojme taksapaguesit qe ushtrojne aktivitet privat (BIZNES), dhe nuk kane paguar detyrimet vendore te vitit 2026, se afati i pageses eshte deri me 30.06.2026, pas kesaj date aplikohen gjoba per mosshlyerje ne afat, sipas ligjit 9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar.